



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 18 dhjetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim ndaj kërkesës së Mbrojtjes lidhur me shtyrjen e afateve**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
Dejvid Hupër

**Mbrojtësit të Kadri Veselit**  
Ben Emerson

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**  
Dejvid Jang

**Mbrojtëses së Jakup Krasniqit**  
Venkatesvari Alagenda

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> bazuar në nenin 41(10) të Ligjit të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ligji") dhe rregullës 9(7), 57(2) dhe 97(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 9, 10 dhe 11 nëntor 2020, pas konfirmimit të aktakuzës<sup>2</sup> kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit ("z. Thaçi", "z. Veseli", "z. Selimi", dhe "z. Krasniqi", bashkërisht "të dyshuarit"), u bënë paraqitjet e para të z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi, dhe z. Krasniqi.<sup>3</sup>

2. Më 4 dhjetor 2020, Mbrojtja e z. Thaçi dorëzoi një kërkesë për lirim të përkohshëm, përfshirë edhe një kërkesë për seancë gojore në lidhje me të ("Kërkesa për lirim të z. Thaçi").<sup>4</sup>

3. Më 7 dhjetor 2020, Mbrojtja e z. Krasniqi dhe Mbrojtja e z. Selimi dorëzuan kërkesat përkatëse për lirim të përkohshëm, përfshirë kërkesa për seancë gojore për këtë çështje ("Kërkesa për lirim të z. Krasniqi" dhe "Kërkesa për lirim të z. Selimi").<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake*, 21 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Versioni i redaktuar publik i vendimit për konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, publik. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Aktakuzë e redaktuar më tej*, 4 nëntor 2020, publike.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës (z. Krasniqi), 9 nëntor 2020, publik; Transkript i seancës (z. Thaçi), 9 nëntor 2020, publik; Transkript i seancës (z. Veseli), 10 nëntor 2020, publik; Transkript i seancës (z. Selimi), 11 nëntor 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00120/RED, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë për lirim të përkohshëm në emër të z. Hashim Thaçi*, 4 dhjetor 2020, publike

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00122, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Kërkesë për lirim të përkohshëm*, 7 dhjetor 2020, konfidenciale, me shtojcat 1-2, konfidenciale, dhe shtojcën 3, publike; F00124/RED, Mbrojtja për z. Selimi, *Kërkesë e Mbrojtjes për lirim të përkohshëm*, 7 dhjetor 2020, publike, me shtojcat 1-3, publike.

4. Më 14 dhjetor 2020, Mbrojtja e të akuzuarve dorëzoi një kërkesë të përbashkët për shtyrjen e afatit për dorëzimin e mocioneve paraprake sipas rregullës 97(1) të Rregullores.<sup>6</sup>

5. Më 10 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera shtyu vendimet lidhur me kërkesat për masa mbrojtëse për dëshmitarë të caktuar të ZPS-së, urdhëroi ZPS-në që deri më 15 janar 2021 të dorëzojë parashtrime plotësuese lidhur me këtë pikë, të cilave Mbrojtja mund t'u përgjigjet brenda 10 ditësh, dhe ndryshoi afatin 30-ditor të rregullës 102(1)(a) të Rregullores për nxjerrjen e çdo materiali që lidhet me këta dëshmitarë ("Vendimi i parë për masa mbrojtëse").<sup>7</sup>

6. Më 16 dhjetor 2020, ZPS-ja iu përgjigj me shkrim kërkesës për lirimin e z. Thaçi.<sup>8</sup>

7. Gjithashtu, më 16 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera: (i) rrëzoi kërkesat e Mbrojtjes për mbajtjen e seancave gojore lidhur me vazhdimin e paraburgimit ose lirimin e të akuzuarve; (ii) i kërkoi ZPS-së që deri më 4 janar 2021 t'i përgjigjet kërkesës për lirim të përkohshëm të dorëzuar nga Mbrojtja e z. Veseli dhe ky i fundit të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij deri më 11 janar 2021; dhe (iii) miratoi kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes për shtyrjen e afateve për dorëzimin e mocioneve paraprake ku kërkonte që mocionet në fjalë të dorëzohen deri më 10 shkurt 2021.<sup>9</sup>

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00137, Mbrojtja e z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi, dhe z. Krasniqi, *Kërkesë e përbashkët e Mbrojtjes për ndryshimin e afatit për parashtrim të mocioneve paraprake*, 14 dhjetor 2020, publike.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00133/COR/CONF/RED, *Version i redaktuar konfidencial i vendimi të parë në lidhje me kërkesën e Prokurorit të Specializuar për masa mbrojtëse*, 10 dhjetor 2020, konfidencial, paras 28, 48, 74, 109, 132(c), (f), (j), (n)-(o) (vendimi iu bë me dije Mbrojtjes më 14 dhjetor 2020). Nxjerrja e kufizuar e informacionit të përcaktuar në këtë paragraf buron nga vendimi i parë konfidencial për masa mbrojtëse dhe nuk ndryshon klasifikimin e vendimit në fjalë.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00149, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës për lirim të përkohshëm në emër të z. Hashim Thaçi*, 16 dhjetor 2020, konfidencial, me shtojcën 1, publike dhe shtojcën 2, konfidenciale.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00150, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi kryerjen e rishikimit të paraburgimit dhe ndryshimin e afatit për mocionet paraprake*, 16 dhjetor 2020, publik, para. 30(a), (c)-(d), (f).

8. Më 17 dhjetor 2020, Mbrojtja e z. Veseli dorëzoi kërkesë për lirim të përkohshëm, përfshirë edhe një kërkesë për seancë gojore lidhur me këtë pikë.<sup>10</sup> Po atë ditë ZPS-ja iu përgjigj me shkrim kërkesës për lirim e z. Krasniqi dhe kërkesës për lirim e z. Selimi.<sup>11</sup>

9. Gjithashtu, më 17 dhjetor 2020, u mbajt konferenca e dytë për ecurinë e çështjes gjyqësore, gjatë të cilës ekipet e Mbrojtjes së z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi parashtruan kërkesa lidhur me afatet për dorëzimin e mocioneve paraprake dhe kundërpërgjigjeve lidhur me kërkesat e tyre përkatëse për lirim të përkohshëm.<sup>12</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE

10. Sipas nenit 41(10) të Ligjit, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formën e prerë ose deri në lirim nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve pas aktvendimit të fundit për paraburgim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose trupi gjyqësor i informuar për rastin shqyrton nëse ekzistojnë ende arsytet për paraburgim dhe nxjerrin aktvendim për lirim apo ndërprerjen e paraburgimit.

11. Në bazë të rregullës 57(2) të Rregullores, pas caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, trupi gjyqësor i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin 41(10), (11) dhe (12) të Ligjit ose me kërkesë të akuzuarit apo Prokurorit të

---

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00151, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë për lirim të përkohshëm të Kadri Veselit*, 17 dhjetor 2020, konfidencial, me shtojcat 1-7, konfidenciale.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, F00153, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës në emër të z. Jakup Krasniqi për lirim të përkohshëm*, 17 dhjetor 2020, konfidencial, me shtojcën 1, konfidencial; F00154, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj kërkesës në emër të z. Rexhep Selimi për lirim të përkohshëm*, 17 dhjetor 2020, konfidencial, me shtojcën 1, konfidenciale.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, Versioni i parë i transkriptit të seancës, 17 dhjetor 2020 ("Versioni i parë i transkriptit i datës 17 dhjetor 2020"), publik, f. 221, rreshti 2 deri në f. 227, rreshti 14.

Specializuar ose *proprio motu*, kur ka pasur ndryshim të rrethanave që nga shqyrtimi i fundit.

12. Në bazë të rregullës 97(2) të Rregullores, i akuzuari mund të dorëzojë mocione paraprake me shkrim brenda tridhjetë ditësh pas nxjerrjes së të gjithë materialit dhe deklaratave të përmendura në rregullën 102(1)(a) të Rregullores.

13. Në bazë të rregullës 76 të Rregullores, përveç nëse përcaktohet ndryshe në Rregullore, përgjigja ndaj një mocioni dorëzohet brenda dhjetë (10) ditësh prej dorëzimit të mocionit, kurse kundërpërgjigja ndaj përgjigjes, në qoftë se ka një të tillë, dorëzohet brenda pesë (5) ditësh prej dorëzimit të përgjigjes. Trupi gjykues merr në shqyrtim kundërpërgjigjen ose pjesë të saj vetëm nëse kanë të bëjnë me çështje të reja që dalin nga përgjigja.

14. Në bazë të rregullës 9(5) të Rregullores, gjykatësi i procedurës paraprake nëse i tregohen arsye të vlefshme ose, *proprio motu*, mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje ose prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

### III. PARASHTRIME

15. Mbrojtja e z. Thaçi kërkon që rregulla 97(2) e Rregullores të interpretohet në mënyrë të atillë që të jepet një afat 30-ditor për dorëzimin e mocioneve paraprake, nga dita e nxjerrjes së materialit për të cilin është shtyrë vendimi prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake në vendimin e parë për masat mbrojtëse, konkretisht 30 ditë duke filluar nga data 15 janar 2021.<sup>13</sup>

16. Gjithashtu, Mbrojtja e z. Thaçi kërkon ndryshim të afatit për dorëzimin e kundërpërgjigjes lidhur me mocionin e vet të datës 7 janar 2020 për lirim të përkohshëm, për shkak të: (i) numrit të madh të parashtrimeve prej ZPS-së dhe

---

<sup>13</sup> Versioni i parë i transkriptit i datës 17 dhjetor 2020, f. 221, rreshti 2 deri në f. 222, rreshti 13.

materialeve mbështetëse që janë dorëzuar në përgjigje të tyre, përfshirë aspekte të reja që kërkojnë hetim; (ii) vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të mos mbajtur seancë gojore për lirim të përkohshëm dhe dëshirës së Mbrojtjes që në vend të seancës gojore të përfshijë në kërkesë pika shtesë për të mbështetur argumentet për lirim të përkohshëm; (iii) vëllimit të punës së njëkohshme të Mbrojtjes dhe pasojat nga pandemia Kovid-19 në punën e tyre; dhe (iv) afatit të datës 11 janar 2021 për kundërpërgjigjen analoge nga Mbrojtja e z. Veseli<sup>14</sup>. Mbrojtja e z. Thaçi heq dorë nga afati për rishikimin e paraburgimit të të akuzuarit brenda dy muajsh nga vendimi i fundit lidhur me këtë pikë.<sup>15</sup>

17. Mbrojtja e z. Selimi dhe Mbrojtja e z. Krasniqi kërkojnë shtyrje të ngjashme të afateve për t'u kundërpërgjigjur lidhur me kërkesat e tyre për lirim të përkohshëm, përfshirë heqjen dorë nga afati dymujor i rishikimit të paraburgimit.<sup>16</sup>

18. ZPS-ja kundërshton si kërkesën që ka të bëjë me mocionet paraprake, po ashtu dhe kërkesat për lirim të përkohshëm, ku argumenton për secilën se: (i) materiali për të cilin është vendosur shtyrja ka gjasa të mos ndikojë në mocionet paraprake duke mbajtur parasysh objektin e kërkesës së këtij të fundit; dhe (ii) ekipet e Mbrojtjes duhej ta kishin informuar plotësisht Gjykatësin e Procedurës Paraprake përmes kërkesave të tyre për lirim të përkohshëm, veçanërisht duke pasur parasysh kuadrin e kufizuar të kundërpërgjigjeve.<sup>17</sup>

---

<sup>14</sup> Versioni i parë i transkriptit i datës 17 dhjetor 2020, f. 222, rreshti 14 deri në f. 225, rreshti 15, f. 229, rreshti 2-4.

<sup>15</sup> Versioni i parë i transkriptit i datës 17 dhjetor 2020, f. 225, rreshti 16 deri në f. 226, rreshti 12.

<sup>16</sup> Versioni i parë i transkriptit i datës 17 dhjetor 2020, f. 226, rreshti 17 deri në f. 227, rreshti 14.

<sup>17</sup> Versioni i parë i transkriptit i datës 17 dhjetor 2020, f. 228, rreshti 7-23.

#### IV. DISKUTIM

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake pajtohet me ZPS-së se, në përputhje me rregullën 76 të Rregullores, kundërpërgjigja duhet të ketë të bëjë vetëm me aspekte të reja që dalin nga përgjigja ndaj një mocioni, prandaj nuk mund të përdoret si mundësi shtesë thjesht për të shtjelluar argumentet që janë paraqitur në vetë mocionin.

20. Sidoqoftë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se në rast se nuk ndryshohen afatet e kërkuara për parashtrimin e kundërpërgjigjeve lidhur me lirimin e përkohshëm, afatet në fjalë do të përkonin me periudhën e ardhshme të pushimit të Gjykatës. Si rrjedhojë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, i vetëdijshëm se ekipet e Mbrojtjes së z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi në këtë rast po heqin dorë nga afati dymujor për rishikimin e paraburgimit si dhe parapëlqimin e tyre për kohë shtesë për dorëzimin e kundërpërgjigjeve lidhur me këtë temë, miraton kërkesat e tyre për ndryshimin e afateve për dorëzimin e kundërpërgjigjeve të tyre përkatëse deri të enjten, 7 janar 2021.

21. Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrton edhe kërkesën e Mbrojtjes së z. Thaçi për të nxjerrë vendim lidhur me afatet për dorëzimin e mocioneve paraprake në këtë çështje gjyqësore, duke mbajtur parasysh shtyrjen prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake të vendimit mbi disa kërkesa të ZPS-së lidhur me nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores. Megjithëse Mbrojtja e z. Thaçi deklaroi se materiali për të cilën është shtyrë vendimi do t'i jepet Mbrojtjes më 15 janar 2021, në vendimin e parë për masat mbrojtëse kjo datë u caktua si afat që ZPS-ja të dorëzonte parashtrime të mëtejshme në lidhje me temën e shtyrjes. Paskëtaj Mbrojtja u ftua të dorëzonte përgjigjen e saj brenda 10 ditësh,. Rrjedhimisht kjo nxiti një sërë ngjarjesh të tjera, përfshi nxjerrjen e vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me shtyrjen dhe, sipas rastit, nxjerrje materialesh plotësuese prej ZPS-së në përputhje me

vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Si rezultat, ndryshimi i mundshëm i afateve mund të jetë më shumë se pesë ditë.<sup>18</sup>

22. Aktualisht ZPS-ja nuk ka materiale shtesë për t'ia dhënë Mbrojtjes sipas rregullës 102(1)(a). Nevoja për të nxjerrë materiale të tilla plotësuese mund të lindë nga vendimi i ardhshëm i gjykatësit lidhur me pikat e përcaktuara në vendimin e parë për masa mbrojtëse. Duke pasur parasysh afatet e përcaktuara më lart, ky vendim do të merret para afatit të fundit të datës 10 shkurt 2021 për dorëzimin e mocioneve paraprake. Rrjedhimisht, nëse në bazë të vendimit të ardhshëm lind nevoja për të nxjerrë materiale të mëtejshme sipas rregullës 102(1)(a) atëherë afati për dorëzimin e mocioneve paraprake do të përshtatet sipas nevojës në atë periudhë.

## V. VENDIM

23. Bazuar në arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **MIRATON** kërkesat e Mbrojtjes së z. Thaçi, z. Selimi dhe z. Krasniqi mbi afatet për dorëzimin e kundërpërgjigjeve përkatëse lidhur me lirimin e përkohshëm dhe e **NDRYSHON** afatin **për të enjten, 7 janar 2021**.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premtë, 18 dhjetor 2020  
Në Hagë, Holandë.

---

<sup>18</sup> Versioni i parë i transkriptit i datës 17 dhjetor 2020, f. 222, rreshti 12-13.